



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:211510
Datë: 08.11.2024
Numri i dokumentit: 06505400

P.nr.4103/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurës F.G nga Prishtina, rruga "...", Blloku ..., hyrja ..., kati ..., nr... , për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3218/19, të datës 16.09.2019, të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurës F.G, av. H.S, në mbështetje të nenit 248 par. 1 nën par. 1.5 të KPP-së, me datën 08.11.2024, jashtë seancës, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hedhje të aktakuzës të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurës F.G av. H.S, ashtu që:
- II.** Procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit F.G e dhënë në polici me atë 10.07.2019, **SHPALLET PROVË E PAPANUESHME**. Kjo provë veçohet nga shkresat e lëndës, ndërsa mund të shqyrtohet vetëm në procedurë sipas ankesës kundër këtij aktvendimi.
- III. HEDHET** aktakuza Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3218/19, të datës 16.09.2019 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurës F.G nga babai S dhe nëna F, mbiemri i vajzërisë së nënës H, e lindur më datë ... në F, Republika e Shqipërisë, tani me vendbanim në P, rruga "...", Blloku ..., hyrja ..., kati ..., nr..., me numër personal ... , shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të KPRK-së, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën akuzohen si në aktakuzë.
- IV.** I dëmtuari A.S, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- V.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3218/19, të datës 16.09.2019, kundër të pandehurës F.G për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pas pranimit të shkresave të lëndës dhe pas kontrollimit të aktakuzës, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 19.12.2023, ashtu që në këtë seancë e pandehura

në prezencën e mbrojtësit të saj ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë. E pandehura me mbrojtësin e saj konform nenit 240 par.7 të KPP-së nga ana e gjykatës janë njoftuar për të drejtën që të paraqesin kundërshtimin e provave dhe kërkesë për hudhje të aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurës F.G av. H.S brenda afatit me datën 16.01.2024, ka paraqitur kundërshtim të provave dhe kërkesë për hudhje të aktakuzës, me ç'rast ka pretenduar se gjykata ka bazë të çmojë provën si të papranueshme, si dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e pandehura e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në kundërshtim të provave mbrojtësi pretendon se aktakuza e prokurorisë është e pabazuar në prova, prokuroria ka dështuar të ofroj prova të siguruara në përputhje me ligjin, e të cilat do të binin një vëzhgues objektiv që ndonjë vepër penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga e pandehura, aktakuza si e tillë ka shumë të meta të cilat e mbajnë atë nën standardin e nevojshëm për të vazhduar tutje me procedurën penale. Tutje, mbrojtësi pretendon se aktakuza është ngritur vetëm mbi bazën e deklaratës së të dëmtuarit – dëshmitarit dhe pjesa tjetër e aktakuzës përmban raportet fillestare, raportet e shpejta të oficerit dhe kallëzimin penal, të cilat nuk e kanë raportin e provës materiale, por kanë karakter operativ të komunikimit mes autoriteteve policore. Më tej, mbrojtësi thekson se në aktakuzë në listën e dëshmitarëve shihet si i propozuar edhe vëllai i të pandehurës F.G, ku dëshmia e të njëjtit është marrë në kundërshtim me standardin e provave në procedurë penale, sepse dëshmitari F.G e ka motër të pandehurën F.G dhe të njëjtit me rastin e intervistimit nuk i janë lexuar të drejtat si dëshmitar i liruar nga detyrimi për të dëshmuar dhe mos leximi i kësaj të drejte kruciale në raport me dëshmitarin paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe paraqet provë të papranueshme, e cila duhet të shpallet si e tillë dhe në kuptim të nenit 243 par. 4 të KPP-së të veçohet nga shkresat e lëndës. Mbrojtësi në kërkesë për hudhje të aktakuzës pretendon se e vetmja provë që e inkriminon të pandehurën, është prova personale – dëshmia e të dëmtuarit A.S. Nga të theksuarat e të dëmtuarit – dëshmitarit lidhur me këtë çështje penale nuk është siguruar asnjë provë në aktakuzë ku do të vërtetonte se e pandehura e ka penguar zyrtarin policor A.S në kryerjen e detyrave zyrtare, qoftë përmes kanosjes apo përdorimit të dhunës, të cilat janë elemente qenësore të veprës penale për të cilën dyshohet e pandehura. Nga provat e lartpërmendura në rastin më të pavolitshëm mund të thuhet se e pandehura ka manifestuar mosbindje ndaj urdhrave të zyrtarit policor lidhur me daljen nga kerri ashtu siç thekson i dëmtuari A.S, veprime këto të cilat mund të përbëjnë kundërvajtje të veçantë, mirëpo në asnjë rrethanë vepër penale ashtu siç i vihet në barrë të pandehurës. Bazuar në të lartcekurat, mbrojtësi propozon që provat në të cilat është mbështetur aktakuza të shpallen prova të papranueshme, aktakuza të hudhet poshtë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e pandehura e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata pas pranimit të kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës, duke u mbështetur në nenin 245 të KPP-së, një kopje të kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës ia ka dërguar Prokurorit të Shtetit për përgjigje me shkrim, me ç'rast prokuroria në përgjigjen e datës 26.01.2024 ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të pandehurës të refuzohet, sepse aktakuza është e bazuar në ligj dhe ka prova të mjaftueshme dhe bindëse të cilat e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se e pandehura e ka kryer veprën penale, e të cilat prova janë siguruar në mënyrë të ligjshme.

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke vlerësuar kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhje të parashtruar nga ana e mbrojtësi i të pandehurës, pas përgjigjes edhe të Prokurorit të Shtetit, si dhe

pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës gjeti se kërkesa e ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurës për kundërshtimin e provave dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës, është e bazuar.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me ligjshmërinë e provave të kundërshtuara.

Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj çështje penale dhe duke analizuar pretendimet e mbrojtësit të të pandehurës për kundërshtimin e provave lidhur me pikën II të aktakuzës, ka gjetur se një sërë veprimesh procedurale nga organet gjegjëse në procedurën paraprake hetimore janë ndërmarr në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ashtu siç me të drejtë pretendon edhe mbrojtja, ku për pasojë ka rezultuar edhe në prova të papranueshme. Këto shkelje ligjore gjatë sigurimit të provave gjatë procedurës paraprake, gjykata do t'i elaboroj me tej si në vijmë të këtij aktvendimi.

Bazuar në faktet që përmban aktakuza, gjykata gjeti se procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit F.G në polici me datë 10.07.2019 është provë e papranueshme për gjykatën, pasi e njëjta është marrë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në lidhje me drejtat të cilat i kanë takuar dëshmitarit në rastin e intervistimit të tij pranë organeve kompetente.

Fillimisht në nenin 124 të KPP-së apo në nenin 127 të Kodit i cili ka qenë në fuqi në kohën e ndërmarrjes së veprimit procedural, janë përcaktuar dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar, ku në paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të këtij neni është përcaktuar se “*nga detyrimi i dëshmimit janë të liruar personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor: paraardhësit, pasardhësit, motrat, vëllezërit, axhët, dajët, tezet, hallat, fëmijët e motrave dhe vëllezërve; ose të afërmit: vjehrra, vjehrrri, dhëndrri, nusja, motra e burrit/gruas, vëllai i burrit/gruas, kumbari, kumbarja, njerka, njerku; përveç kur procedura zbatohet për veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë (10) vjet burgim apo nëse është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës i cili bashkëjeton apo është i afërm me të apo me të pandehurin*”. Ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se “*Organi kompetent që zbaton procedurën detyrohet që personat e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, para marrjes së tyre në pyetje ose sapo të mësojë për marrëdhënien e tyre me të pandehurin, t'i bëjë me dije për të drejtën e tyre për të mos dëshmuar. Paralajmërimi dhe përgjigjja shënohen në procesverbal*”.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se dëshmitari F.G është intervistuar në polici me datë 10.07.2024 në cilësi të dëshmitarit nga zyrtari policor V.B, pasi që ditën kritike dyshohet se dëshmitari ka qenë në veturë me të pandehurën F.G kur pretendohet se e njëjta ka kryer veprën penale si në aktakuzë. Po ashtu, është fakt i pakontestueshëm se dëshmitari e ka motër të pandehurën F.G, gjë që e kanë potencuar vet dëshmitari, por edhe e pandehura dhe një gjë e tillë është vërtetuar edhe nga dëshmia e dhënë në këtë procesverbal, përkundër kësaj, zyrtari policor në asnjë rast nuk e ka njoftuar dëshmitarin për të drejtën e tij se është i liruar nga detyrimi për të dëshmuar, por në procesverbal dëshmitarit vetëm i është tërhequr vërejtja që të flas të vërtetën dhe është njoftuar për pasojat ligjore për deklaram të rremë, në anën tjetër askund nuk shihet se është bërë përpjekje apo janë ndërmarr veprimet tjera procedurale në drejtim të leximit të të drejtave në kuptim të nenit 172 të KPP-së i aplikueshëm në rastin konkret. Duke qenë se dëshmitarit nuk i janë lexuar të drejtat se është i liruar nga detyrimi për të dëshmuar, gjykata erdhi në përfundim se procesverbali i intervistimit në rastin konkret, e në të cilën edhe

mbështetur aktakuza, nuk është marrë në mënyrë të ligjshme, andaj edhe është provë e papranueshme.

Se deklarata e dëshmitarit F.G është provë e papranueshme, gjen mbështetje në dispozitën e nenit 125 par. 1 nën par. 1.2 të KPP-së, ku është përcaktuar *“Dëshmia e dëshmitarit është e papranueshme nëse: 1.2 personi është i liruar nga dëshmimi, por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal”*. Prandaj, mbrojtësi me të drejtë ka pretenduar se mos leximi i kësaj të drejte në raport me dëshmitarin F.G që është vëllai i të pandehurës F.G paraqet shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe si rrjedhojë e kësaj prova si e tillë shpallet provë e papranueshme dhe veçohet nga shkresat e lëndës, ashtu siç përcaktohet edhe në 243 (nenit 249 të Kodit Nr.04/L-123) par.4 të KPP-së, ku shprehimisht *“Provat e papranueshme ndahen nga shkresat dhe mbyllen. Provat e tilla mbahen nga gjykata të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Provat e papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo të shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë”*

Përveç kësaj, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, përveç tjerash në nenin 251 paragrafi 2 parasheh se *“Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu, ndërsa paragrafi 3 i këtij neni shprehimisht parasheh se “Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme”*. Andaj, bazuar në të lartcekurat edhe u vendos sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimi i gjykatës lidhur me hedhjen e aktakuzës.

Lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë të pandehurës me aktakuzë, gjykata vlerëson se në këtë çështje penale duhet të hedhet aktakuza, për faktin se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e pandehura e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës gjeti se e vetmja provë mbi të cilën mbështetet aktakuza, është deklarata e dëshmitarit F G, e cila deklaratë është shpallë provë e pranueshme me arsyet si më lartë.

Prokuroria në arsyetimin e aktakuzës përveç deklaratës së dëshmitarit F.G, i referohet edhe raportit të zyrtarit policor A.S i përpiluar me datë 10.07.2019, e në të cilën edhe e mbështet tërë aktakuzën dhe pretendimin se e pandehura e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Mirëpo, për gjykatën ky raport policor nuk paraqet provë, e njëjta është vetëm raport në bazë të të cilit organi i ndjekjes ka qenë dashur të filloj dhe zbatoj hetimet, pra një raport i tillë është komunikim mes autoriteteve policore, ashtu siç me të drejtë pretendon edhe mbrojtësi i të pandehurës në kërkesën për hüdhe të aktakuzës, por assesi nuk mund të përdoret si provë në procedurë penale dhe nuk paraqet bazë edhe për ngritjen e aktakuzës. Bazuar në provat e pretenduara nga ana e prokurorisë, e në të cilat edhe është mbështetur aktakuza, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk plotësohet stadi i dyshimit të bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës. Dispozita e nenit 19 paragrafi 1 pika 1.12 shprehimisht ka përcaktuar se *“dyshimi i bazuar mirë nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”*.

Nga të lartcekurat gjykata është bazuar në dispozitën ligjore të nenit 7 të KPPRK-së, ku përcaktohet detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, përkatësisht paragrafi 1 i këtij neni i cili ka paraparë se: “Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm” tutje paragrafi 2, parashih se: “Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurve si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t’i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit”.

Për këto arsye, pas analizimit të shkresave të lëndës të paraqitura nga prokuroria dhe duke qenë se procesverbal i intervistimit të dëshmitarit F.G në polici u shpall provë e papranueshme dhe në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë tjetër për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e pandehura e ka kryer këtë vepër penale dhe rrjedhimisht aktakuza është mbështetur mbi bazën e provave të papranueshme, në mbështetje të nenit 248 paragrafi 1, pika 1.5 të KPP-së gjykata vendosi që ta hedh aktakuzën dhe ta pushoj procedurën penale ndaj të pandehurës F.G për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par. 1 të KPP-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e të dëmtuarit në kontest juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 par. 3 të KPP-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Prandaj, nga arsyet e lartcekura dhe bazuar në nenin 243 paragrafi 3 dhe 4, si dhe nenit 248 par. 1 nën par. 1.5 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.4103/19, me datë 08.11.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.